

URDHËR
Nr.9, datë 10.3.2005

**PËR SEKUESTRIMIN E PASURIVE TË FONDACIONIT "TAIBAH INTERNATIONAL", E
NJOHUR DHE SI SHOQATA NDËRKOMBËTARE E NDIHMAVE, I CILI REZULTON I
SHPALLUR NË LISTËN E FINANCUESVE TË TERRORIZMIT**

Në mbështetje të nenit 102 pika 2 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe në zbatim të ligjit nr.9258, datë 15.7.2004 "Për masat kundër financimit të terrorizmit", të ligjit nr.8865, datë 14.3.2002 "Për ratifikimin e konventës së Kombeve të Bashkuara për luftën kundër financimit të terrorizmit" e vitit 1999, të rezolutave të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara në këtë drejtim, të nenit 17 e vijues të ligjit nr.9284, datë 30.9.2004 "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar", të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.718, datë 29.10.2004 "Për listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit",

URDHËROJ:

1. Të sekuestrohen menjëherë të gjitha pasuritë (llogaritë, investimet dhe asetet) mbajtur në emër, për llogari, prej, ose në përfitim të:

1.1 Fondacionit "Taibah International", i njohur dhe si "Shoqata Ndërkombëtare e Ndihmave".

2. Të ndalohet menjëherë dhënia e shërbimeve financiare, fondeve, mjeteve financiare ose asetëve të tjera përmes Shqipërisë, për fondacionin e lartpërmendur.

3. Të sekuestrohen të gjitha llogaritë bankare të identifikuara deri aktualisht, në emër të, prej, për llogari, ose në përfitim të fondacionit të lartpërmendur të specifikuar dhe renditur më poshtë.

4. Të sekuestrohet menjëherë çdo lloj pasurie, e luajtshme ose e paluajtshme, zotërimi i tyre, mbajtur në emër, prej, për llogari, ose në përfitim fondacionit të lartpërmendur, të pasurive të tjera ekzistuese pavarësisht nga pronësia aktuale, në rast se subjekti, ndonjëri nga emrat e identifikuar, kanë qenë pronar i tyre nga data e shpalljes në listën e Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

5. Të kryhet sekuestrimi ose bllokimi i llogarive, investimeve, shoqërive tregtare a personave juridikë të tjerë dhe pasurive të tjera ekzistuese pavarësisht nga pronësia aktuale, në rast se subjekti, nën ndonjërin nga emrat e identifikuar, ka qenë pronari i tyre, duke filluar nga data 11 maj 2004 e shpalljes në listë të Kombeve të Bashkuara.

6. Kur llogaritë, investimet ose pasuritë e tjera janë shitur, ndërsa kanë qenë të ngrira, të bllokuara ose të sekuestruara, ky urdhër shtrihet mbi të ardhurat e krijuara nga shpërbërjet, shitjet ose zotërimet e llogarive, investimeve ose pasurive të vendosura nën kontrollin e institucioneve të ngarkuara nga legjislacioni në fuqi.

7. Të gjithë personat, që kanë detyrime kontraktuale, të lidhura përpara datës së këtij urdhri, me fondacionin "Taibah International", i njohur dhe si Shoqata Ndërkombëtare e Ndihmave, depozitojnë në llogarinë e çelur pranë Bankës së Shqipërisë nga Ministria e Financave.

8. Të ndalohet dhënia e shërbimeve financiare, mjeteve financiare ose pasurive të tjera subjekteve ose ndonjë personi fizik ose juridik të dyshuar se financon ose ndihmon subjektin e lartpërmendur. Nëse vëreni, konstatoni një mbështetje ose ndihmë të kësaj natyre, duhet të përgatisni dhe të dorëzoni një raport të aktivitetit të dyshimtë të drejtori i Autoritetit Përgjegjës për Parandalimin e Pastrimit të Parave në Ministrinë e Financave.

9. Të plotësohet raporti i aktivitetit të dyshimtë (RAD) për transaksionet që transferojnë pronësinë e llogarive, investimeve ose të pasurive të tjera të mbajtura nga subjektet duke filluar nga data 11 maj 2004 e shpalljes në listën e Kombeve të Bashkuara, si dhe për ato të cilat nuk është kryer ngrirja ose bllokimi nga institucioni juaj financiar. RAD dërgohet te Drejtori i Autoritetit Përgjegjës për Parandalimin e Pastrimit të Parave në Ministrinë e Financave menjëherë dhe jo më vonë se 72 orë nga data e hyrjes në fuqi të këtij urdhri.

10. Të njoftohen menjëherë me shkrim, brenda datës 20.3.2005, drejtori i Autoritetit Përgjegjës për Parandalimin e Pastrimit të Parave në Ministrinë e Financave dhe administratori i përkohshëm për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, deri në ngritjen e agjencisë përkatëse, për llogaritë bankare, pasuritë, investimet dhe aktivitetet e tjera, si dhe për

vendndodhjen e tyre.

11. Ngarkohen me zbatimin e këtij urdhri institucionet e përcaktuara në ligjin nr.9258 datë 15.7.2004 "Për masat kundër financimit të terrorizmit"; Ministria e Financave, Autoriteti Përgjegjës për Parandalimin e Pastrimit të Parave në Ministrinë e Financave, Ministria e Rendit Publik, Shërbimi Informativ Shtetëror, Prokuroria e Përgjithshme, Banka Qendrore e Shqipërisë, bankat e nivelit të dytë, subjektet dhe autoritetet e tjera raportuese të ligjit nr.8610, datë 17.5.2000 "Për parandalimin e pastrimit të parave", i ndryshuar, si dhe administratori i përkohshëm i Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, i përcaktuar me urdhër të Ministrit të Financave nr.586, datë 28.1.2005, deri në krijimin e Agjencisë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara.

12. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Arben Malaj